



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike
Mbledhja nr. 10
Prishtinë, më 13 prill 2010, në orën 11: 00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJE TË FINANCEVE PUBLIKE

Në mbledhje morën pjesë: Haki Shatri, Safete Hadergjonaj, Kosara Nikoliq, Arsim Rexhepi, Riza Smaka, Synavere Rysha, Anita Morina-Saraçi dhe Enis Kervan.

Mungoi: Gani Koci.

Të pranishëm: Zyra e Komisioneve të Kuvendit, Fatime Qorri - zyrtare ligjore, KIPRED (staf mbështetës) Artan Venhari dhe Albert Krasniqi, Shpresa Miftari – praktikante, ZAP – Ilire Daija – Buza, Zyra e Presidentit - Nexhat Shatri.

Mbledhjen e kryesoi Haki Shatri - kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. **Miratimi i rendit të ditës,**
2. **Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 30. 03. 2010,**
3. **Përgatitje rreth dëgjimit publik për shqyrtimin e Raportit të auditimit të performancës në shpërndarjen e barnave esenciale nga Departamenti Farmaceutik i Ministrisë së Shëndetësisë,**
4. **Të ndryshme.**

Kryesuesi konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesi – I njoftoi anëtarët e Komisionit se Udhëzimi administrativ nr. 2008/01, për të cilin u akuzua në mbledhjen e kaluar, është udhëzim i parë administrativ, i nënshkruar nga ministri Ahmet Shala. Po ashtu i njoftoi anëtarët e Komisionit se më nuk është anëtar i Komisionit për Buxhet dhe Financa. Shtoi se në mbledhjen e Komisionit për Buxhet dhe Financa, të datës 30 mars 2010, janë shqyrtuar Raporti i KRPP-së dhe Raporti i Auditorit të Përgjithshëm. Në atë mbledhje është hequr nga rendi i ditës pjesa që kishte të bënte me mënyrën e shpenzimit të parasë publike. Po ashtu pati reagime, që nëse në këtë Komision ajo nuk do të ishte pjesë për diskutim dhe nëse në Komisionin për Buxhet hiqet ajo, si e panevojshme, kush do të ishte kompetent të merrej me pjesën në të cilën flitet, si janë kryer prokurimet, sa shkelje, sa ankesa dhe sa procedura të parregullta ka pasur? Kjo e kishte shtyrë të mendonte se e gjithë situata në

mbledhjen e kaluar ishte me prapavijë politike. Kur flitet për Raportin e AKK-së, për pjesën përmbajtjesore, nuk ka komision më kompetent se KMFP-ja për të diskutuar për të.

Lidhur me rendin e ditës, në pikën të ndryshme, propozoi të përfshihej formimi i komisionit vlerësues, për përzgjedhjen e auditorit të jashtëm për auditimin e pasqyrave financiare të Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2008 dhe 2009.

Arsim Rexhepi – Lidhur me Udhëzimin administrativ, që ishte temë debati në mbledhjen e kaluar, tha se për hir të transparencës ka kërkuar të vërtetohet se kur është nënshkruar ai udhëzim. Kryesuesit i kërkoi falje nëse është ndier i fyer. Propozoi që në rend dite të përfshihen edhe dy propozimet nga mbledhja e kaluar: kërkesë për Auditorin e Përgjithshëm për Raportin e audituar të RTK-së dhe për auditimin e Fondit për Mjetet e Privatizimit.

Safete Hadergjonaj – I njoftoi anëtarët e Komisionit se dalja e saj dhe e deputetit Gani Koci nga mbledhja e kaluar, nuk ka qenë çështje politike ose personale, por thjeshtë çështje procedurale. Në Komisionin për Buxhet dhe Financa, nuk është hequr raporti i KRPP-së dhe i OSHP-së, por i AKK-së, sepse Komision Funkcional për shqyrtimin e këtyre raporteve është Komisioni për Legjislacion. Raportin e AKK-së deri më tani e ka shqyrtuar edhe Komisioni për Siguri.

Riza Smaka – Ishte i mendimit se KMFP-ja duhet të jetë komision serioz dhe ta ushtrojë seriozisht funksionin e vet. Insistoi që në rend dite të përfshihet kërkesa që KMFP-ja duhet t'ia bëjë Auditorit të Përgjithshëm për revizionin e Bankës Qendrore. Është fjala për 450 milionë euro të tretura. Ka të dhëna se në BQ ka shumë spekulime, manovrime, abuzime etj.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike e miratoi rendin e ditës pa ndryshime. Në këtë rend dite, në pikën të ndryshme, do të përfshihen:

- a) Formimi i komisionit vlerësues për përzgjedhjen e auditorit të jashtëm për auditimin e pasqyrave financiare të Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2008 dhe 2009,*
- b). Diskutim rreth propozimit për Raportin e audituar të RTK-së,*
- c). Diskutim rreth propozimit për auditimin e Fondit për Mjetet e Privatizimit.*

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 30. 3. 2010

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike e miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 30 mars 2010, pa vërejtje.

3. Përgatitje rreth dëgjimit publik për shqyrtimin e Raportit të auditimit të performancës në shpërndarjen e barnave esenciale nga Departamenti Farmaceutik i Ministrisë së Shëndetësisë

Kryesuesi – I njoftoi anëtarët e Komisionit se për këtë pikë të rendit të ditës i ftuar ka qenë edhe eksperti Robert Reeve nga Zyra Kombëtare e Auditit. Meqenëse në Mbretërinë e Bashkuar janë zgjedhjet dhe sipas rregullave të Mbretërisë së Bashkuar paraqitja e tij para mediave është pengesë, por ne duhet të punojmë në bazë të rregullave të Kuvendit. I lus mediat që në pjesën, kur eksperti do të takohet me Komisionin, ta lirojnë sallën për një periudhë të shkurtër kohore.

Raporti i paraparë për këtë rend dite, është dokument i përgatitur nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm. Komisioni po planifikon ta organizojë një dëgjim publik për shqyrtimin e këtij Raporti. Të ftuar do të jenë Auditori i Përgjithshëm dhe përfaqësues të Ministrisë së Shëndetësisë. Rregullore të brendshme të Komisionit nuk ka, por janë pajtuar që edhe këtu të vlejnjë praktikatat nga vizita në Londër. Hap diskutimin.

Safete Hadergjonaj – Tha se me Raportin e performancës janë ngritur shumë shqetësime. Shumë shifra nuk përputhen. Ka dallime të mëdha midis kërkesave të cilat janë bërë dhe furnizimeve. Depoja nuk i plotëson standardet dhe ka shumë çështje të tjera të cilat janë

shqetësim i vazhdueshëm. Në mbledhjen e sotme do të duhej të ishin të pranishëm përfaqësuesit e ZAP-it, sepse mundësia për të marrë njoftime, për t'u njohur me natyrën e punës, me problemet ose me çështjet e paraqitura në Raport, do të ishte më e madhe. Në bazë të këtyre sqarimeve do të përgatitej seanca dëgjimore dhe pyetjet për përfaqësuesit e Ministrisë së Shëndetësisë. Vetëm kështu mund të japim shembull se ky Komision po e kryen funksionin e tij. Pa praninë e përfaqësuesve të ZAP-it, debati është i paarsyeshëm. Pas seancës dëgjimore Komisioni do të mund të japë rekomandime ose të pajtohet plotësisht me rekomandimet që i ka dhënë Auditori.

Kryesuesi – Eksperti ka rekomanduar që Auditori i Përgjithshëm të mos ftohet dy herë. Në seancën dëgjimore do të jenë të ftuar Auditori i Përgjithshëm dhe përfaqësuesit e MSH-së. Është obligim i Auditorit të Përgjithshëm të bashkëpunojë me secilin prej anëtarëve të Komisionit dhe t'u japë njoftime lidhur me këtë materie. Nga të gjeturat kryesore shihet se shfrytëzimi i parasë publike në fushën e furnizimit me barna, është shumë shqetësues. Ka parregullsi të mëdha në planifikimin, shpërndarjen, shfrytëzimin dhe procedimin deri te furnizimi i pacientëve me barna. Vetëm në vitin 2008 janë shpenzuar 15 milionë euro. Pas seancës dëgjimore, përveç rekomandimeve, do të kërkojmë edhe veprime konkrete. A do të përfundojë puna e Komisionit pas këtyre konstatimeve dhe rekomandimeve, apo është një rrugë që keqpërdoruesin e çon në derën e caktuar? Në rast se konstatojmë se ka shkelje të rëndë, a duhet t'i bëjmë ftesë prokurorit ta marrë këtë materie dhe ta procedojë më tutje? Komisioni vetëm e përgatit një opinion si janë shpenzuar paratë publike. Institucionet përkatëse e kanë për detyrë të merren më tutje me këtë çështje. Si do të bëhet ajo konkretisht, është çështje që nuk është e përcaktuar me rregulla të Komisionit ose të punës së Kuvendit.

Riza Smaka – Auditori ka bërë punë serioze dhe ka nxjerrë konkluzione, të cilat për Komisionin janë shqetësuese. Nuk është zgjidhje normative ose përkatëse të shkruhen rekomandime. Rekomandimi është një porosi e butë, është e karakterit moralizues, por jo juridik. Auditori nuk është dashur të kërkonte nga Departamenti Farmaceutik të jepte udhëzime, por të kërkonte që ministri i Shëndetësisë të jepte instruksione detyruese. Në parim, edhe me dispozitat e Kushtetutës, statusi i Auditorit nuk është ai që do të duhej të ishte. Revizioni është institucion shumë profesional dhe shumë autoritativ për të dhënë udhëzime, rekomandime etj. Në anën tjetër prokuroritë nuk reagojnë edhe pse ka denoncime penale për persona të caktuar, nuk ka gjykim përfundimtar etj. Dihet mirë se janë 250 mijë lëndë të grumbulluara. Prandaj epilogu i këtyre do të mbetet rekomandime, porosi dhe udhëzime. Ai që e zbaton normën është më përgjegjës për të bërë diçka, për të ndryshuar dispozita të caktuara në të mirë të përforcimit të funksionit të auditimit.

Synavere Rysha – Raporti është i shkurtër, por i hollësishëm. Auditori e ka bërë auditimin e performancës për furnizimin me barna esenciale nga MSH-ja në spitale dhe në qendra të mjekësisë familjare në Kosovë. Gjatë kësaj procedure shihet se ka pasur probleme të ndryshme. Nga të gjeturat kryesore, që i ka paraqitur Auditori janë renditur gjithsej “nëntë”. E gjetura e fundit ka përfunduar me fjalët “*korruption dhe keqmenaxhim*”. Janë dy konstatime të Auditorit. Auditorët janë persona shumë profesionalë, por puna e tyre përfundon me rekomandim, që nëse kuptohet drejt e merr formën e ligjit. Rekomandimi i Auditorit detyron më së shumti. Në seancën dëgjimore duhet të ftohen ata që e bëjnë furnizimin me barna esenciale. Ne si KMFP duhet t'i sfidojmë me pyetje. Nga të gjeturat mund të procedojmë në stadin tjetër - paraqitja në gjykatë.

Safete Hadergjonaj - Komisioni nuk është ai që e procedon çështjen në gjykatë. Ai bën rekomandime, të cilat janë publike. Është detyrë e institucioneve të tjera të merren me këtë çështje.

Anita Morina – Saraçi – Është një keqmenaxhim i përgjithshëm në Departamentin Farmaceutik. Kjo është shqetësuese për secilin. Në seancën dëgjimore, që ky Komision planifikon ta organizojë, patjetër duhet të marrim informata të hollësishme dhe të kërkojmë përgjegjësi nga Ministria e Shëndetësisë për keqmenaxhimin dhe për keqpërdorimin e mjeteve.

Në konsultim me ekspertë të kësaj fushe dhe me njerëz që kanë përvojë nga vendet e tjera, të vendosim si të veprojmë. Nuk janë deputetët ata të cilët mund ta procedojnë Raportin në Prokuroi. Është prokuroi ai që mund të hapë procedurë nëse sheh keqmenaxhim.

Arsim Rexhepi – Ky Raport është fragment i një kozmosi të tërë i korrupsionit dhe i mafies. Në Kosovë ka struktura mafioze dhe i gjithë tregu është në duar të rrezikshme, që drejtpërdrejt po e dëmtojnë shëndetin e gjithmbarshëm të popullatës. Të gjithë pacientët janë të detyruar të blejnë barna përkundër listës esenciale të barnave, të cilat duhet detyrimisht t'i ketë klinika. Ky dokument duhet t'i shërbejë politikës, sepse është bërë për politikën. Në seancën dëgjimore do ta mbështesim këtë Raport. Kjo të mos mbarojë me një seancë dëgjimore. T'ia imponojmë plenumit të merret me një çështje kaq të ndjeshme. Ky Raport mund të na shërbejë si bazë që Kuvendi i Kosovës ta diskutojë këtë çështje në një pikë të veçantë të rendit të ditës. Pastaj si politikë t'ua dërgojmë organeve të tjera.

Enis Kervan – Në Raport janë përfshirë vetëm dy mostra. Në ftesën që do të bëhet për MSH-në të mos përqendrohemi vetëm në këto dy qendra spitalore, sepse problemet janë më të mëdha.

Kryesuesi konstatoi se KMFP-ja do të organizojë dëgjim publik lidhur për shqyrtimin e Raportit të auditimit të performancës në shpërndarjen e barnave esenciale nga Departamenti Farmaceutik – Ministria e Shëndetësisë.

4. Të ndryshme

a) Formimi i komisionit vlerësues për përzgjedhjen e auditorit të jashtëm për auditimin e pasqyrave financiare të Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2008 dhe 2009

Kryesuesi - Sipas vendimit të Kryesisë së Kuvendit, Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike e formon komision vlerësues prej pesë anëtarëve. Punët profesionale janë kryer nga Zyra e Prokurimit në Kuvendin e Kosovës. Hap diskutimin.

Safete Hadergjonaj – Tha se është kundër asaj që KMFP-ja të merret me këtë çështje. Vlerësimin e ofertave duhet ta bëjë administrata e Kuvendit të Kosovës, pastaj ato të procedohen për vendosje në këtë Komision.

Enis Kervan – Vendimi i Kryesisë e detyron Komisionin pesë anëtarësh. Nuk pajtohem që me vlerësimin e ofertave – çështje teknike - të merret Komisioni. Personalisht nuk marr pjesë në atë Komision.

Arsim Rexhepi – Vendimi i Kryesisë na detyron. Ne duhet ta kryejmë detyrën që kërkohet prej nesh.

Synavere Rysha – Me këto çështje është dashur të merret Sekretaria e Kuvendit. Meqenëse e ishte një vendim që duhet përfillur, u pajtua të jetë anëtare e këtij Komisioni.

Kosara Nikoliq – Vendimi është i Kryesisë, por kjo nuk do të thotë se duhet të ndërhyjnë në përzgjedhjen e auditorit. Këtë duhet ta bëjnë Shërbimet Publike. Ne e bëjmë kontrollin dhe e japim mendimin para se kjo të dalë në publik. Anëtarët e Komisionit nuk duhet të marrin pjesë në vlerësimin e ofertave.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike e nxori këtë

VENDIM

Formohet komisioni vlerësues për përzgjedhjen e auditorit të jashtëm për auditimin e pasqyrave financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2008 dhe 2009.

Anëtarë të këtij komisioni do të jenë:

Riza SMAKA – kryesues,

Gani KOCI – anëtar,

Synavere RYSHA – anëtare,

Anita MORINA – SARAÇI - anëtare dhe

Kosara NIKOLIQ - anëtare.

b). Diskutim rreth propozimit për Raportin e audituar të RTK-së

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike i Kuvendit të Republikës së Kosovës, bazuar në kërkesën e anëtarëve të Komisionit, ka vendosur që Auditorit të Përgjithshëm t'ia paraqesë këtë

KËRKESË

Që në Kuvendin e Republikës së Kosovës ta procedojë Raportin e auditimit të jashtëm, të pavarur për pasqyrat financiare dhe të performancës së RTK-së.

c). Diskutim rreth propozimit për auditimin e Fondit për Mjetet e Privatizimit

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike i Kuvendit të Republikës së Kosovës, bazuar në kërkesën e anëtarëve të Komisionit, për auditimin e Bankës Qendrore, përkitazi me mjetet e Fondit të Privatizimit, ka vendosur që Auditorit të Përgjithshëm t'ia paraqesë këtë

KËRKESË

T'i fillojë procedurat e auditimit dhe të përpilojë raport lidhur me mjetet e Fondit të Privatizimit.

Mbledhja përfundoi në orën 12:40

E përqatiti:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Haki Shatri